

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 28 numër 2 qershor 2026

Data e botimit: 8.6.2026

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 18, datë 6.5.2026
"Për miratimin e raportit tremujor të politikës monetare" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 19, datë 6.5.2026
"Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes
dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore
dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 20, datë 6.5.2026
"Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 15.1.2025, të Këshillit Mbikëqyrës
të Bankës së Shqipërisë "Për miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël
dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqërues", i ndryshuar" 8
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 21, datë 6.5.2026
"Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së
konfidencialitetit midis Bankës së Shqipërisë dhe Frankfurt School of Finance &
Management gGMBH" 10
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 22, datë 6.5.2026 "Për
dhënien e licencës degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti
Ziraat Bankasi A.S., Albania" në Republikën e Shqipërisë" 11
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 25, datë 3.6.2026
"Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 5.11.2025, të Këshillit Mbikëqyrës
"Për ekspozimin e disa vlerave numizmatike, pjesë e fondit numizmatik të Bankës
së Shqipërisë, në ekspozitën e organizuar me rastin e 100-vjetorit të Bankës së
Shqipërisë" 13
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 27, datë 3.6.2026 "Për
disa ndryshime në rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin
e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", e ndryshuar" 15
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 28, numër 1, prill 2026 16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 18, datë 6.5.2026

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TREMUJOR TË POLITIKËS MONETARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "ç" dhe të nenit 69, pika 5 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Raportin tremujor të politikës monetare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin dhe për dërgimin e këtij raporti në Kuvendin e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave dhe në institucionet e tjera përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 19, datë 6.5.2026

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 20, datë 6.5.2026

**PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 15.1.2025, TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË BIZNESIT MIKRO,
TË VOGËL DHE TË MESËM NË SHQIPËRI DHE DOKUMENTACIONIT
SHOQËRUES", I NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "a", nenit 16, pika 1, shkronja "i", nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 3, pika 7, të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare", miratuar me vendimin nr. 81, datë 16.12.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 15.1.2025, të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqëruës", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në pikën 1, Aneksi 1 "Program për Financimin e Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm", bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. paragrafi A.2, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:
"Përfituesit potencialë janë të gjitha subjektet, të cilat klasifikohen si ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, sipas ligjit nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme", pavarësisht sektorit të tyre të veprimtarisë, si dhe fermerët e regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë. Këtu e në vazhdim, përfituesit

- potencialë të këtij programi do të referohen si "BVM";*
- ii. në paragrafin B.1, togfjalëshi: "*31 dhjetor 2026*", zëvendësohet me togfjalëshin: "*31 dhjetor 2027*";
 - iii. në paragrafin B.2., në paragrafin e dytë, fjalia e dytë dhe e tretë ndryshohen sipas përmbajtjes vijuese: "*Kufiri maksimal i një kredie ose kufiri kumulativ i disa kredive të disbursuara nga një bankë individuale, për një BVM sipas parashikimeve të paragrafit A.2, nuk mund të jetë më e madhe se 175.000.000 lekë.*";
- b) Në pikën 2, Aneksi 2 "*Marrëveshja Kuadër "Për pjesëmarrjen në Programin e Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri, ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave"*, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në nenin 1, pas fjalës "*të Mesëm*", shtohet togfjalëshi: "*si dhe për fermerët e regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë*",
 - ii. në nenin 3, pika 2, data "*31.12.2031*", zëvendësohet me datën "*31.12.2034*".,
 - iii. në nenin 4, pika 1, shkronja "a", pas fjalës "*të mesme*", shtohet togfjalëshi: "*si dhe për fermerët e regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë;*",
 - iv. në nenin 4, pika 1, shkronja "c", shuma "*25.000.000 lekë*", zëvendësohet me shumën: "*175.000.000 lekë*",
 - v. në nenin 4, pika 1, shkronja "d", afati "*5 vjet*", zëvendësohet me afatin: "*7 vjet*",
 - vi. në nenin 4, pika 2, data "*20.12.2025*", zëvendësohet me datën "*20.12.2027*";
- c) Në pikën 3, Aneksi 3 "*Kontrata Tip "Për lëvrimin e fondeve nga Programi i financimit të biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri, ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankës"*", në nenin 3, shkronja "b", pas fjalës "*të mesme*", shtohet togfjalëshi "*si dhe fermerët e regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë.*".
2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Statistikave Financiare dhe Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 21, datë 6.5.2026

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË KONFIDENCIALITETIT MIDIS
BANKËS SË SHQIPËRISË DHE FRANKFURT SCHOOL OF FINANCE &
MANAGEMENT GGBH**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe bazuar në propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Dytë të Bankës së Shqipërisë për nënshkrimin e Marrëveshjes së Konfidencialitetit midis Bankës së Shqipërisë dhe Frankfurt School of Finance & Management gGmbH.
2. Ngarkohet Departamenti i Statistikave Financiare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 22, datë 6.5.2026

**PËR
DHËNIEN E LICENCËS DEGËS SË BANKËS SË HUAJ "DEGA E BANKËS
TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S., ALBANIA" NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 14, 20, 21, 23 pika 2 dhe 54 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 2 të Shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010 të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" në Republikën e Shqipërisë.
2. Në zbatim të nenit 23, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dega e bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" do të ushtrojë veprimtaritë bankare dhe financiare që ushtron banka e huaj "Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S", të cilat lejohen dhe parashikohen në ligjin nr.9662,

datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Ngarkohet Guvernatori me nënshkrimin e licencës dhe të aneksit të veprimtarive të degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania", pas paraqitjes në Bankën e Shqipërisë të konfirmimit të autoritetit licencues dhe/ose mbikëqyrës përgjegjës në Republikën e Turqisë për bankën e huaj "Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S" në lidhje me veprimtaritë bankare dhe financiare që ushtron kjo bankë.
4. Ngarkohet dega e bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" që të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për datën e fillimit të veprimtarisë.
5. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Operacioneve Monetare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 25, datë 3.6.2026

**PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 62, DATË 5.11.2025, TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS "PËR EKSPOZIMIN E DISA VLERAVE NUMIZMATIKE, PJESË
E FONDIT NUMIZMATIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË, NË EKSPOZITËN E
ORGANIZUAR ME RASTIN E 100-VJETORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 9, pika 2, shkronja "d", dhe nenit 14, shkronja "b", të rregullores "Për funksionimin e Departamentit të Kërkimeve", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 30.3.2016; të nenit 5, pika 1, shkronja "b", dhe nenit 6, shkronja "a", të rregullores "Për organizimin e ekspozitave të përkohshme të vlerave numizmatike dhe objekteve muzeore të Bankës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 50, datë 3.9.2025, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozimin e Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 62, datë 5.11.2025, të Këshillit Mbikëqyrës "Për ekspozimin e disa vlerave numizmatike, pjesë e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë, në ekspozitën e organizuar me rastin e "100-vjetorit të Bankës së Shqipërisë", bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në pikën 1, togfjalëshi:

"në datat 28 nëntor 2025 – 28 maj 2026"

zëvendësohet me togfjalëshin:

"në datat 28 nëntor 2025 – 18 janar 2027".

2. Ngarkohen Departamenti i Kërkimeve, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Komisioni i Administrimit të Vlerave të Ekspozitës, i ngritur për këtë qëllim, me ndjekjen e procedurave përkatëse për administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e vlerave numizmatike gjatë periudhës së zgjatur të ekspozimit.
3. Ngarkohet Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes me ndjekjen e procedurave përkatëse të sigurisë gjatë periudhës së zgjatur të ekspozimit.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 27, datë 3.6.2026

**PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR STRUKTURËN E PAGAVE
BAZUAR NË KLASIFIKIMIN E VENDEVE PËRKATËSE TË PUNËS NË BANKËN
E SHQIPËRISË", E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "f", nenit 45, pika 2 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë:

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.108, datë 24.12.2003, të ndryshuar, pika 8 e nenit 12 shfuqizohet.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 28, NUMËR 1, PRILL 2026

1. Vendim i Zëvendësgubernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 431, datë 19.1.2026, "Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë të agjentit në sigurime nga subjekti financiar jobankë "Tirana Factoring & Lease" sh.a."
2. Vendim i Zëvendësgubernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 526, datë 21.1.2026, "Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "NOA" sh.a."
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 4, datë 25.3.2026, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 25.3.2026, "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2025"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 25.3.2026, "Për dhënien e licencës bankës "Banka Jet" sh.a. në Republikën e Shqipërisë"
6. Vendim i Gubernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2366, datë 25.3.2026, "Për miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme"
7. Vendim i Gubernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2534, datë 31.3.2026, "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 8, datë 1.4.2026, "Për miratimin e "Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2025"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë"
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka"
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave"
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre"
13. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 13, datë 1.4.2026, "Për një ndryshim në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"
14. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 14, datë 1.4.2026, "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 20 Lekë"
15. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 1.4.2026, "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 5000 Lekë"
16. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.16, datë 1.4.2026 "Për emërimin e Zëvendësgubernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë"